



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar ▾Shërbime ▾Baza ligjore ▾Vendndodhjet e policisë ▾Video
- Programi i transparencës ▾Kontakt ▾Denonco Krimin Kibernetik ▾Drejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rugore ▾
- Donacione ▾Rubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja Javore ▾Për sinjalizimin

Breaking News: Fier – Operacioni “Tempulli”, 2 shtetas të tjerë në pranga, sekuestrohen 430 doza cannabisi
Shkodër – Qarkullonin në qytet, me armë zjarri pistoletë dhe me lëndë narkotike, në pranga 2 shtetas
Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Sinkroni”
Policia Rugore, plan masash për evidentimin e shkeljeve që janë burim aksidenti
Policia e Shtetit dhe Policia italiane, konferencë për luftën e përbashkët kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike



LajmetOperacionet

14/12/2023

Shkodër – Qarkullonin Në Qytet, Me Armë Zjarri Pistoletë Dhe Me Lëndë Narkotike, Në Pranga 2 Shtetas

Shkodër/Vijojnë kontrollet në të gjithë qarkun, në zbatim të planeve operacionale “Sundimi i ligjit” dhe “Tempulli”.

Si rezultat i kontrolleve të ushtruara bazuar në informacionet e siguruara nga intelijenca policore, është goditur një rast i armëmbajtjes pa leje dhe një rast në fushën e narkotikëve.

Qarkullonin në qytet, me armë zjarri pistoletë dhe me lëndë narkotike, në automjet, kapen në flagrancë dhe vihen në pranga një 18-vjeçar dhe një 23-vjeçar.

23-vjeçari, i dyshuar si posedues i lëndës narkotike që u gjet në automjet, me precedent të mëparshëm penal në fushën e narkotikëve.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë, lënda narkotike kanabis, automjeti dhe 2 celularë.

Si rezultat i kontrolleve të pandërprera të ushtruara në zbatim të planeve operacionale “Sundimi i ligjit” dhe “Tempulli”, bazuar dhe në informacionet e siguruara nga intelijenca policore, nga strukturat e DVP Shkodër është goditur një rast në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe një rast në fushën e narkotikëve.

Shërbimet e Patrullës së Përgjithshme të Komisarariatit të Policisë Shkodër, në rrugën “Ethem Osmani”, kanë ndaluar për kontroll automjetin tip “Audi” me të cilin qarkullonin shtetasit R. V. dhe N. K.

Gjatë kontrollit në këtë automjet dhe kontrollit fizik ndaj këtyre shtetasve, shërbimet e Policisë kanë gjetur 1 armë zjarri pistoletë që dyshohet se e posedonte shtetasi R. V. dhe një sasi lënde të dyshuar narkotike kanabis që dyshohet se e posedonte shtetasi N. K.

Arma e zjarrit pistoletë dhe lënda narkotike u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin në pronësi të shtetasit N. K. dhe 2 celularë.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore dhe procedurale, specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër arrestuan në flagrancë shtetasit R. V., 18 vjeç, banues në Vaun e Dejës dhe N. K., 23 vjeç, banues në Shkodër.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Sinkroni”

Fier – Operacioni “Tempulli”, 2 shtetas të tjerë në pranga, sekuestrohen 430 doza cannabisi ▶